



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
MINISTRIA E FINANCVE

RAPORT I REALIZIMIT TË BUXHETIT TË
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË
VERIUT

JANAR – QERSHOR 2026

Shkup, korrik 2026

PËRMBAJTJA

Përmbledhje.....	2
1. Tendencat ekonomike ndërkombëtare.....	3
2. Tendencat makroekonomike në vend.....	4
2.1. Aktiviteti ekonomik.....	4
2.2. Tregu i fuqisë punëtore	6
2.3. Inflacioni dhe lëvizjet monetare	6
2.4. Bilanci i pagesave	7
2.5. Perspektiva makroekonomike për vitin 2026.....	8
3. Sektori fiskal.....	10
3.1. Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut	10
3.1.1. Realizimi i buxhetit themelor.....	12
3.1.2 Realizimi i buxhetit të fondeve	14
3.1.3 Realizimi i buxhetit të llogarive vetanake për të ardhurat e shfrytëzuesve buxhetorë	15
3.1.4 Realizimi i Buxhetit të RMV-së sipas shfrytëzuesve buxhetorë	15
3.2. Menaxhimi i borxhit publik.....	17

Përmbledhje

- Gjatë tremujorit të parë të vitit 2026, aktiviteti ekonomik shënoi rritje reale prej 3.1%, i nxitur nga kërkesa e brendshme. Shtytësi kryesor i rritjes ishte konsumi privat, i mbështetur nga rritja e të ardhurave të disponueshme të amvisërive, si dhe kontributi pozitiv i konsumit publik dhe investimeve bruto;
- Sipas të dhënave në Anketën e Fuqisë Punëtore (AFP), shkalla e papunësisë në T1 2026 ishte 11.3%, që paraqet ulje prej 0.1 pikë përqindjeje (p.p.) në krahasim me tremujorin paraprak, si dhe 0.4 p.p. në krahasim me tremujorin e njëjtë të vitit 2025;
- Gjatë gjysmës së parë të vitit 2026, norma mesatare e inflacionit ishte 4.1% në nivel vjetor, ku nxitësit kryesorë ishin komponenti ushqimor dhe inflacioni bazë. Çmimet e produkteve ushqimore u rritën për 4.9%, ndërsa çmimet e energjisë dhe karburanteve regjistruan rritje prej 2.1% dhe 7.9%. Inflacioni bazik ishte 3.7%;
- Sipas skenarit makroekonomik në Strategjinë fiskale 2027-2031, rritja ekonomike në vitin 2026 pritet që të arrijë 3.5%. Kërkesa vendase pritet që të ketë kontribut të konsiderueshëm pozitiv ndaj rritjes, njëkohësisht me ngadalësimin e kontributit negativ të eksportit neto;
- Gjatë periudhës janar – qershor të vitit 2026, të ardhurat e përgjithshme buxhetore u realizuan në vlerë prej 169,944 milionë denarë, që paraqet 45.3% e vlerës së planifikuar për vitin 2026 dhe në krahasim me gjysmën e parë të vitit të kaluar, ato shënuan rritje për 8.6%;
- Realizimi i shpenzimeve të përgjithshme buxhetore gjatë periudhës janar – qershor të vitit 2026 ishte 205,887 milionë denarë, që paraqet 49.7% të planit vjetor dhe në krahasim me gjysmën e parë të vitit të kaluar ato u rritën për 10.6%;
- Gjatë periudhës janar – qershor të vitit 2026, në Buxhetin e RMV-së u realizua deficit prej 35,943 milionë denarëve, që paraqet 3.24% të PBB-së së projektuar për vitin 2026, si dhe deficit primar në vlerë prej 2.16% të PBB-së së projektuar për vitin 2026;
- Borxhi shtetëror i RMV-së në fund të tremujorit të parë të vitit 2026 ishte 51.9% të PBB-së, ndërsa borxhi publik ishte 58.9% të PBB-së.

1. Tendencat ekonomike ndërkombëtare¹

Ekonomia globale vazhdon të përballët me pasiguri të lartë, me perspektivën ekonomike të formësuar nga kombinim i risqeve gjeopolitike dhe ndryshimeve strukturore që lidhen me progresin teknologjik. Ndërsa aktiviteti ekonomik global mbetet relativisht rezistente, perspektivat e rritjes janë më të ulëta se mesatarja historike, ndërsa procesi i dezinflacionit është ngadalësuar për shkak të rritjes së sërishme të çmimeve të energjisë dhe pasigurisë së shtuar.


Konflikti në Lindjen e Mesme paraqet goditje negative sa i përket ofertës, duke ndikuar në çmimet e energjisë dhe rrugët e transportit. Njëkohësisht, investimet e përshpejtuara dhe zbatimi i mjeteve të Inteligjencës Artificiale (IA) paraqesin faktor strukturor pozitiv, i cili ka potencialin të rrisë produktivitetin dhe rritjen e mundshme ekonomike në periudhë afatmesme. Sipas FMN-së, ekonomia globale i rezistoi goditjes së shkaktuar nga konflikti më mirë se sa pritej, me pasojat në kanalet kryesore të transmetimit: çmimet e lëndëve të para, pritshmëritë për inflacionin dhe kushtet financiare, mbeten të kufizuara.

Sipas raportit të muajit qershor të FMN-së, rritja ekonomike globale parashikohet të ngadalësohet nga 3.5% në vitin 2025 në 3.0% në vitin 2026, me ç'rast për të gjitha vendet pothuajse është bërë rishikim në rënie të rritjes krahasuar me raportin e muajit janari, para shpërthimit të luftës në Lindjen e Mesme. Rritja për vitin 2026 shënoi rishikim në rënie me 0.3 pikë përqindjeje (p.p.) krahasuar me muajin janar dhe është nën mesataren historike prej 3.7% (2000–2019).

Rritja në eurozonë pritet të ketë rënie nga 1.4% në vitin 2025 në 0.9% në vitin 2026, me ç'rast projekcioni për vitin 2026 u rishikua në rënie për 0.2 p.p. në krahasim me raportin e muajit prill. Presioni nga çmimet më të larta të energjisë dhe besimi i dobët i konsumatorëve janë faktorët kryesorë për rritjen më të ulët.

Inflacioni global pritet që ta ndërpresë tendencën e tij të dizinflacionit të nisur në fillim të vitit 2024. Ai parashikohet të rritet nga 4.1% në vitin 2025 në 4.7% në vitin 2026, përpara se të ulet në 3.9% në vitin 2027. Rritja në vitin 2026 i atribuohet kryesisht çmimeve më të larta të energjisë dhe produkteve ushqimore. Dinamika e inflacionit pritet të jetë e ndryshme nga një vend në tjetrin, duke reflektuar diferencat në karakteristikat ekonomike dhe shkallën e ekspozimit ndaj konfliktit. Për ekonominë e zhvilluara, inflacioni për vitin 2026 është rishikuar në linjë të sipërme për 0.2 p.p. krahasuar me muajin prill dhe shënon 3.0%, ndërsa inflacioni në eurozonë pritet të arrijë në 2.9% në vitin 2026, para se të ulet në 2.3% në vitin 2027.

Grafiku 1. Rritja reale e PBB-së (%)



Në rrethanat tilla, hartuesit e politikave ekonomike përballen me sfidën e vendosjes së ekuilibrit midis kontrollit të inflacionit, mbështetjes së aktivitetit ekonomik dhe mbrojtjes së amvisërive të shtresave në nevojë. Politika monetare mbetet e orientuar në ruajtjen e stabilitetit të çmimeve, ndërsa prioritet i politikës fiskale është

¹ Analiza në këtë pjesë bazohet mbi raportin e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) të muajit prill dhe korrik të vitit 2026.

rikuperimi gradual i hapësirës fiskale, në kushtet e rritjes së nivelit të borxhit publik, kostove më të larta të huamarrjes dhe pasigurisë së madhe të jashtme.

Risku i drejtpërdrejt për projeksionet rezulton nga zhvillimet e mëtejshme në Lindjen e Mesme. Përshkallëzim i sërishëm i tensioneve gjeopolitike do të çregullonte rritjen dhe do të ndikojë edhe mbi rritjen e presionit të inflacionit, përmes rritjes së mëtejshme të çmimeve të lëndëve të para dhe rritjes së paqëndrueshmërisë të çmimeve. Nga ana tjetër, rihapja e ngushticës së Hormuzit dhe çmimet më të ulëta të lëndëve të para do të nënkuptonin rritje më të lartë dhe inflacion më të ulët. Përveç risqeve negative rënësë që lidhen me tensionet gjeopolitike, ekziston edhe risku në rritje në periudhë afatmesme nëse investimet lidhur me IA-në mbeten të fuqishme dhe shndërrohen më shpejt në zbatim më të gjerë dhe produktivitet më të lartë. Njëkohësisht, ekziston risku i kundërt nëse profitabiliteti dhe efektet e produktivitetit të IA-së rezultojnë të jenë më të ulëta se sa pritej, gjë që mund të çojë në çrregullime të tregut financiar dhe paqëndrueshmëri makrofinanciare.


2. Tendencat makroekonomike në vend²

2.1. Aktiviteti ekonomik

Në tremujorin e parë të vitit 2026, Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) shënoi rritje vjetore prej 3.1% në bazë reale, që tregon për vazhdimin e zhvillimeve pozitive ekonomike dhe rezistencën e ekonomisë vendase në kushte pasigurie në mjedisin ekonomik global. Rritja ekonomike u nxit nga kërkesa e brendshme, e mbështetur nga konsumi final më i lartë dhe investimet bruto. Konsumi privat, si nxitësi kryesor i aktivitetit ekonomik, u rrit për 2.6% në bazë reale, ndërsa rritja e tij u mbështet nga rritja e të ardhurave në dispozicion të amvisërve, si rezultat i rritjes së punësimit, rritjes së pagave dhe pensione, si dhe kreditimit të shtuar të amvisërve. Njëkohësisht, konsumi publik shënoi rritje reale prej 5.5%.

Investimet bruto realizuan rritje reale prej 1.5%, e mbështetur nga shpenzimet më të larta kapitale dhe aktiviteti i përforcuar i ndërtimtarisë. Stimulues shtesë në aktivitetin e investimeve siguruan investimet e huaja direkte dhe rritja e kreditimit për korporatat, të cilat u rritën për 46.8% dhe 15.0%. Eksporti i mallrave dhe shërbimeve vazhduan tendencën pozitive të vitit të kaluar, duke arritur rritje reale prej 6.2%, ndërsa importi u rrit me 5.2%. Megjithatë, pavarësisht shkallës së lartë të rritjes së eksportit, për shkak të pjesëmarrjes më të lartë të importit në shkëmbimin e përgjithshëm tregtar, eksporti neto kishte kontribut negativ mbi rritjen ekonomike.

Grafiku 2. Struktura e shpenzimeve të rritjes ekonomike (kontributi në rritje, pikë përqindje)




Duke analizuar sipas veprimtarive, rritja e aktivitetit ekonomik gjatë tremujorit të parë të vitit 2026, u nxit nga sektori i shërbimeve, me kontribut të konsiderueshëm edhe në ndërtimtarinë dhe bujqësinë. Në sektorin e shërbimeve u realizua rritje prej 3.6%, ku të gjitha veprimtaritë shënuan norma pozitive të rritjes. Rritja më e lartë

² Në raport shfrytëzohen të dhënat më të fundit në dispozicion. Për PBB-në, papunësinë dhe bilancin e pagesave, të dhënat janë të disponueshme përfshirë tremujorin e parë të vitit 2026.


u realizua në veprimtaritë profesionale, shkencore dhe veprimtaritë teknike me (6.1%), ndërsa kontribut më të madh mbi rritjen e sektorit të shërbimeve kishte tregtia, transporti dhe hotelieria, me rritje prej 3.7% dhe kontribute prej 0.7 p.p.. Ndërtimtaria shënoi rritje të lartë prej 7.2%, kryesisht si rezultat i rritjes së vlerës së punëve të kryera ndërtimore të ndërtimet e ulëta me realizim dyfishor prej 24.5%. Aktivitetet e specializuara të ndërtimore vazhduan të rriten për 17.5%, ndërsa rënie kishte të ndërtimet e larta për 30.6%. Rritja në sektorin e ndërtimit vazhdon të jetë kryesisht rezultat i realizimit të projekteve kapitale dhe infrastrukturore. Bujqësia shënoi rritje prej 2.9%, ndërsa sektori industrial shënoi rënie prej 0.8%.

Grafiku 3. Struktura e rritjes ekonomike sipas metodës prodhuese (kontributi në rritje, p.p.)



Sipas të dhënave me frekuencë të lartë, prodhimi industrial në muajin maj të vitit 2026 shënoi rënie vjetore prej 2.0%. Në bazë kumulative, gjatë periudhës janar – maj të vitit 2026, prodhimi industrial shënoi ulje për 0.3%, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Rënia në muajin maj ishte kryesisht përshkak të uljes së prodhimit në sektorin e minierave dhe gurorëve (-3.6%) dhe në sektorin e industrisë së përpunimit (-2.6%), ndërsa në sektorin e furnizimit me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar shënoi rritje prej 6.1%.

Grafiku 4. Rritja vjetore e prodhimit industrial (në %)



Tregtia e jashtme vazhdoi tendencën pozitive të vitit të kaluar, me ç'rast gjatë periudhës janar-maj të vitit 2026, eksporti i mallrave shënoi rritje prej 5.6%, kryesisht si rezultat i rritjes së eksportit të produkteve kimike (20.9%), naftës (258.7%) dhe metaleve me ngjyrë (160.0%). Importi i mallrave shënoi rritje kumulative vjetore prej 5.8%, si rezultat i rritjes së importit të produkteve ndërmjetëse (8.1%) dhe produkteve të konsumit të gjerë (1.9%). Importi i mallrave në vlerë absolute shënoi rritje më të lartë se eksporti, me ç'rast deficit tregtar shënoi rritje për 6.3% në bazë vjetore.

Numri i lejeve të lëshuara të ndërtimit, në muajin maj të vitit 2026 shënoi ulje për 27.5% në nivel vjetor, ndërsa vlera e përgjithshme e punëve të parashikuara ndërtimore shënoi rënie prej 15.2%, që tregon ngadalësim

të aktivitetit ndërtimor dhe impuls më të dobët investues krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Megjithatë, gjatë periudhës janar – maj të vitit 2026, pavarësisht uljes së numrit të lejeve të lëshuara për 21.3%, vlera e përgjithshme e punimeve ndërtimore të parashikuara u rrit për 21.4%. Rritja rezultoi nga vlera më e lartë të ndërtimit të ulët (+65.5%) dhe rikonstruimet (+58.8%), ku rritja të ndërtimit të ulët u nxit nga strukturat komplekse industriale (+1.087.5%), ndërsa ndërtimet e larta shënuan rënie prej 15.8%.

Në muajin maj të vitit 2026, sa i përket tregtisë së brendshme, u evidentua rënie nominale e qarkullimit prej 4.6% në nivel vjetor. Ulja ishte rezultat i qarkullimit më të ulët në tregtinë me shumicë (-16.9%) dhe në tregtinë me automjete motorike (-6.7%), që tejkaloi rritjen e realizuar në tregtinë me pakicë (11.7%). Në bazë kumulative, në periudhën janar–maj 2026, tregtia e brendshme shënoi rënie nominale prej 7.1% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.


2.2. Tregu i fuqisë punëtore

Sipas të dhënave të Anketës së Fuqisë Punëtore (AFP), shkalla e papunësisë në T1 2026 ishte 11.3%, që paraqet ulje për 0.1% pikë përqindjeje (p.p.), në krahasim me tremujorin e kaluar, përkatësisht 0.4% p.p. në raport me tremujorin e njëjtë të vitit 2025.

Njëkohësisht, shkalla e punësisë arriti në 46.5%, duke shënuar rënie prej 0.3 p.p., në krahasim me tremujorin e kaluar dhe rritje të konsiderueshme prej 0.2 p.p. në raport me tremujorin e parë të vitit 2025. Përkatësisht, numri i të punësuarve shënoi ulje për 2,138 persona (0.3%) në krahasim me tremujorin e kaluar, ndërsa në nivel vjetor, ky numër shënoi rritje për 4,975 persona (0.7%). Shkalla e aktivitetit ishte 52.5%, që paraqet rritje prej 0.1 p.p., në krahasim me tremujorin e parë të vitit 2025, ndërsa në raport me tremujorin e kaluar është vërejtur ulje prej 0.3 p.p..

Gjatë katër muajve të parë të vitit 2026, paga mesatare neto shënoi rritje prej 7.8% në bazë nominale. Rritja e pagave u regjistrua në të gjitha veprimtaritë, me rritje më të theksuar në veprimtaritë financiare, veprimtaritë administrative dhe shërbyese, si dhe ndihmëse, furnizimin me ujë, tregtinë, objektet për akomodim dhe veprimtaritë e shërbimit me ushqime etj.

Grafiku 5. Rritja e pagës mesatare neto (në %)




2.3. Inflacioni dhe lëvizjet monetare

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2026, norma mesatare e inflacionit shënon 4.1% në nivel vjetor. Pas tendencës fillestare rënëse gjatë dy muajve të parë të vitit, në muajin mars u shënuar sërish përsheptimi i rritjes së çmimeve, kryesisht të atyre ushqimore. Kjo rritje i atribuohet pjesërisht bazës më të ulët krahasuese, por edhe ndikimit të zhvillimeve aktuale gjeopolitike. Përsheptimi i çmimeve vazhdoi në muajin prill dhe maj, ndërsa në muajin qershor u shënuar ngadalësimi i rritjes së çmimeve. Në mënyrë kumulative, çmimet në kategorinë e ushqimeve dhe pijeve joalkoolike u rritën për 5.3%, ndërsa vetëm çmimet e ushqimeve shënuan rritje prej 4.9%.

Në gjashtë muajt e parë, çmimet e energjisë dhe karburanteve u rritën përkatësisht për 2.1% dhe 7.9%. Inflacioni bazë shënon 3.7%.

Grafiku 6. Inflacioni i përgjithshëm dhe ai bazë (në %)




Në muajin qershor të vitit 2026, norma bazë e interesit u rrit për 0.25 p.p., përkatësisht nga 4% në 4.25%. Kjo është rritja e parë e normës bazë të interesit pas gjashtë muajsh nga vendosja e kornizës së re operative monetare në muajin dhjetor të vitit 2025, ku instrumenti kryesor u bënë bonot e thesarit 7-ditore, me normë interesi prej 4%, në vend të instrumentit të mëparshëm me afat maturimi prej 7 javësh dhe normë interesi prej 5.35%. Shtërëngimi i moderuar i politikës monetare vjen si pasojë e pranisë së efekteve ekonomike të zhvillimeve gjeopolitike (konfliktit në Lindjen e Mesme), ndërsa pasiguria lidhur me ritmin e stabilizimit të plotë të zhvillimeve vazhdon të krijojë risqe. Gjithashtu, në mbledhjen e fundit të BQE-së, normat e interesit u rritën për 0.25 p.p, që përbën faktor shtesë që merret parasysh gjatë marrjes së vendimeve monetare në vend.

Në muajin maj të vitit 2026, aktiviteti kreditor u rrit për 13.4% në nivel vjetor në kushtet e rritjes së kreditimit të ndërmarrjeve për 15.0% dhe amvisërive për 12.0%, ndërsa potenciali i përgjithshëm i depozitave ka realizuar rritje vjetore prej 8.6%.

2.4. Bilanci i pagesave

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2026, llogaria rrjedhëse e bilancit të pagesave ka evidentuar deficit prej 294.9 milionë eurove, ku ka shënuar ulje për 41.6 milionë eurove (12.4%) në krahasim me deficitin në tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar, kryesisht është si rezultat i rënies së deficit në llogarinë e mallrave (5.6%), ndërsa ndikim negativ kishte ulja e suficitit në llogarinë e shërbimeve (1.9%) dhe rritja e maturuar e deficitit në llogarinë e të ardhurave primare (2.7%).

Grafiku 7. Saldoja e llogarisë rrjedhëse dhe fluksi hyrës i IHD-ve (në miliona euro)



Investimet e Huaja Direkte (IHD) gjatë tremujorit të parë të vitit 2026 ishin 218,6 milionë euro dhe krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit të kaluar, shënuan rritje për 46.8%, përkatësisht për 70 milionë euro, që kryesisht ishte për shkak të rritjes së fluksit hyrës në bazë të instrumenteve të borxhit.

Vlera e rezervave devizore në muajin qershor të vitit 2026 ishin në vlerë prej 4.9 miliardë eurove, që paraqet rritje prej 5.1% në nivel vjetor, duke siguruar mbulimin e importit të mallrave dhe shërbimeve prej 4.7 muajve nga perioda e mëparshme 12-mujore, që paraqet nivel përkatës rezervash.

2.5. Perspektiva makroekonomike për vitin 2026

Në kushte të mjedisit të jashtëm sa i përket pasigurisë, si rezultat i konfliktit në Lindjen e Mesme, i cili përmes tregjeve të produkteve primare dhe pritshmërive të inflacionit ndikon negativisht në aktivitetin ekonomik, projeksioni për rritjen reale të PBB-së për vitin 2026 u rishikua në rënie në muajin prill dhe arrin në 3.5%, (nga 3.8% më parë). Shtytësi kryesor i rritjes pritet që të jetë konsumi vendas.

Investimet bruto pritet që sërish ta kenë rolin kryesor në nxitjen e aktivitetit ekonomik me projektim real në nivel vjetor prej 7.2%. Kjo rritje do të nxitet përmes investimeve publike kapitale, të cilat do ta përmirësojnë infrastrukturën dhe do të rrisin konkurrencën e ekonomisë vendase. Kontribut pozitiv pritet edhe nga realizimi i projekteve kapitale në komuna, të cilat duhet të kontribuojnë në zhvillimin e barabartë rajonal, si dhe nga projektet që realizohen në fushën e arsimit, shëndetësisë dhe mjedisit jetësor. Aktiviteti investues i kompanive vendase pritet të mbetet në nivel të lartë, duke pasur parasysh aktivitetin e lartë kreditor, të mbështetur edhe nga mjetet e favorshme të siguruar nga Qeveria.

Rritja e kërkesës së brendshme do të mbështetet edhe nga konsumi. Në vitin 2026, konsumi privat pritet të shënojë rritje reale prej 2.3%, ndërsa ndikimi i presioneve të çmimeve mbi të ardhurat e familjeve do të neutralizohet nga rritja e pagave, rritja e pensioneve, si dhe nga masat e Qeverisë për lehtësimin e efekteve të goditjes së çmimeve. Konsumi publik në vitin 2026 është projektuar të rritet për 2.5%.

Pritshmëritë e reduktuara për kërkesën e jashtme dhe rritjen ekonomike globale në vitin 2026 pritet të ndikojnë edhe në aktivitetin e eksportit dhe importit. Në këto kushte, rritja e eksportit është projektuar në 4.1%. Në kushte të rritjes së moderuar të aktivitetit eksportues dhe kërkesës së brendshme, rritja reale e importit të mallrave dhe shërbimeve në vitin 2026 është projektuar në 4.2%, që inplikon kontribut negativ të eksportit neto në rritjen ekonomike.

Zhvillimet pozitive në tregun e punës pritet të vazhdojnë gjatë gjithë vitit 2026, si rezultat i investimeve dhe nevojës për fuqi punëtore, të mbështetura nga masat dhe aktivitetet për krijimin e vendeve të reja të punës. Rritja e aktivitetit ekonomik në vitin 2026, do të reflektohet në punësim, me rritje të projektuar të numrit të të punësuarve prej 1.5%. Njëkohësisht, pritet që papunësia të ulet, ku norma e papunësisë në vitin 2026 është projektuar të ulet në 11.0%, ndërsa norma e punësimit pritet të arrijë në 47.0%.

Tensionet gjeopolitike, veçanërisht ato që lidhen me konfliktin në Lindjen e Mesme, si dhe rritja e çmimeve të naftës, kontribuojnë në rritjen e pritshmërive të inflacionit. Në vitin 2026, inflacioni pritet të arrijë në 4.5%, pas së cilës parashikohet të ulet gradualisht në periodhën në vijim. Megjithatë, perspektiva e inflacionit mbetet e shoqëruar në nivel të konsiderueshëm pasigurie. Në periodhë afatshkurtër, risqet vlerësohen kryesisht si negative, për shkak të mundësisë së rritjes së mëtejshme të çmimeve të energjensave dhe produkteve primare.

Në vitin 2026, saldoja e llogarisë rrjedhëse e bilancit të pagesave pritet të zgjerohet krahasuar me vitin paraprak dhe të arrijë në 5.0% të PBB-së, si rezultat i rritjes së pritshme të deficitit tregtar, si pasojë e çmimeve më të larta të produkteve primare, veçanërisht të naftës. Zhvillimet pozitive në flukset hyrëse të IHD-ve pritet të vazhdojnë në vitin 2026, gjë që do të ketë ndikim të favorshëm në ruajtjen e rezervave devizore në nivel të përshtatshëm.

Sipas skenarit bazë makroekonomik me risqe të theksuara, të cilat vlerësohen si risqe në rënie në raport me rritjen ekonomike të projektuar. Mundësia e përshkallëzimit të konfliktit në Lindjen e Mesme mund të shkaktojë rritje të mëtejshme të çmimeve të energjensave dhe të krijojë vështirësi serioze edhe në disponueshmërinë e tyre, veçanërisht për vendet më pak të zhvilluara. Një situatë e tillë mund të reflektohet shpejt në çmimet e produkteve të tjera primare dhe lëndëve të para, të shkaktojë çrregullime në zinxhirët e

furnizimit dhe të përforcojë pritshmëritë e inflacionit. Pasiguria në rritje dhe përkeqësimi i besimit në nivel ndërkombëtar mund t'i ngadalësojë vendimet e kompanive për t'i realizuar investimet e planifikuara. Sa u përket faktorëve të brendshëm, realizimi më i ngadalshëm i investimeve kapitale dhe i reformave të planifikuara mund ta prolongojnë dinamizimin e pritshëm të aktivitetit ekonomik.

Tabela 1. Krahasimi i projeksioneve të rritjes ekonomike dhe inflacionit për vitin 2026 (në %)

	Rritja ekonomike	Inflacioni
Ministria e financave	3.5	4.5
FMN-ja	3.1	4.5
Banka Botërore	2.9	3.4
Komisioni Evropian	3.2	4.4
BERZH-i	3.0	/
Agjencia Kreditore "Fitch"	3.0	4.4
Banka Popullore e RMV-së	3.5	4.0


Burimi: Projektionet e Ministrisë së Financave (Strategjia fiskale 2027 - 2031, prill 2026), FMN-së (IMF World Economic Outlook, prill 2026), Bankës Botërore (Western Balkans Regular Economic Report, prill 2026), Komisionit Evropian (European Economic Forecast, maj 2026), BERZH-it (Regional Economic Prospects, maj 2026), Agjencisë Kreditore "Fitch" (Fitch Ratings, mart 2026) dhe Bankës Popullore të RMV-së (Raporti tremujor, prill 2026).

3. Sektori fiskal

3.1. Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut

Me Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut të vitit 2026, të ardhurat e përgjithshme janë planifikuar të jenë në vlerë prej 374,935 milionë denarëve, shpenzimet e përgjithshme në vlerë prej 414,174 milionë denarëve, përkatësisht deficitin është planifikuar në vlerë prej 39,239 milionë denarëve (deficitin i buxhetit themelor 32,870 milionë denarë, deficitin i fondeve 1,315 milionë denarë dhe deficitin i llogarive për të ardhurat vetanake 5,054 milionë denarë).

Grafiku 8. Pasqyra skematike e Buxhetit të RMV-së, realizimi (në miliona denarë) dhe shkalla e realizimit (në %) në gjysmën e parë të vitit 2026



Realizimi i të ardhurave të përgjithshme buxhetore në periudhën janar – qershor 2026 ishte 169,944 milionë denarë, që paraqet 45.3% e vlerës së planikuar për vitin 2026, përkatësisht rritje prej 8.6% krahasuar me të ardhurat e realizuara buxhetore në të njëjtën periudhë të vitit 2025 (Tabela 2). Në kuadër të të ardhurave të përgjithshme, 155,462 milionë denarë janë realizuar në bazë të të ardhurave tatimore dhe kontributve sociale, me ç'rast shkalla e realizimit ishte 46.3% nga vlera e planifikuar për vitin 2026, përkatësisht rritje prej 9.2% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Gjithashtu, të ardhurat tatimore u realizuan në vlerë të përgjithshme prej 96,710 milionë denarëve³ (realizim prej 45.2% të vlerës së planifikuar për vitin 2026), ndërkohë që kontributet u realizuan në vlerë prej 169,944 milionë denarëve (ritje vjetore prej 7.5%, përkatësisht 48.2% nga vlera e planifikuar për vitin 2026). Në kuadër të të ardhurave tatimore vërehet rritje te detyrimet tatimore për 8.3%, tatimi mbi të ardhurat personale për 11.7%, tatimi mbi vlerën e shtuar për 16.4%, tatimi mbi fitimin për 14.5%, ndërsa te të ardhurat e tjera tatimore u shënuar rënie për 57.4% dhe te akcizat për 4.1%.

Realizimi i shpenzimeve të përgjithshme të Buxhetit të RMV-së në periudhën janar – qershor të vitit 2026 ishte 205,887 milionë denarë, që paraqet 49.7% të planit vjetor, përkatësisht rritje prej 10.6%, krahasuar me gjysmëvjetorin e vitit 2025. Gjithashtu, shpenzimet rrjedhëse u realizuan në vlerë 186,516 milionë denarë ose 49.9% nga vlera e planifikuar për të gjithë vitin, që paraqet rritje prej 7.4% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2025. Rritje kishte te shpenzimet për mallrat dhe shërbimet për 25.1% dhe te pagat dhe kompensimet për 8.5%. Transferrat, që janë kategoria më e madhe e shpenzimeve rrjedhëse, u rritën për 7%, të nxitura nga rritja e

³ Gjithashtu përfshihen edhe të ardhurat nga llogaritë vetanake në vlerë prej 1,285 milionë denarëve.

lartë e transfertave sociale prej 10.1%, shpenzimet për mbrojtjen shëndetësore prej 6.1%, dotacionet blok dhe ato të destinuara prej 8.2%. Shpenzimet kapitale u realizuan në vlerë prej 19,371 milionë denarë, respektivisht ishin më të larta për 53.5% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2025. Shkalla e realizimit të shpenzimeve kapitale në gjysmëvjetorin e parë në lidhje me buxhetin fillestar ishte 48.3%.

Tabela 2. Realizimi i Buxhetit të RMV-së për periudhën janar – qershor 2026

Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut

	Buxheti 2026	janar - qershor 2026		
	miliona denarë	miliona denarë	shkalla vjetore e rritjes (në %)	shkalla e realizimit
TË ARDHURAT E PËRGJITHSHME	374,935	169,944	8.6%	45.3%
Tatime dhe kontribute	335,971	155,462	9.2%	46.3%
Tatime	214,149	96,710	10.3%	45.2%
Tatimi mbi të ardhurat personale	38,797	17,539	11.7%	45.2%
Tatimi mbi fitimin	26,572	13,809	14.5%	52.0%
TVSH	92,506	43,258	16.4%	46.8%
Akciza	35,838	13,949	-4.1%	38.9%
Detyrime importi	16,597	7,652	8.3%	46.1%
Të ardhura të tjera tatimore	3,839	503	-57.4%	13.1%
Kontribute	121,822	58,752	7.5%	48.2%
Të ardhura jotatimore	29,060	12,456	11.7%	42.9%
Të ardhura kapitale	2,510	575	20.5%	22.9%
Donacione nga jashtë	7,394	1,451	-41.9%	19.6%
Të ardhura nga huatë e arkëtuara	0	0	/	/
SHPENZIMET E PËRGJITHSHME	414,174	205,887	10.6%	49.7%
Shpenzime rrjedhëse	374,052	186,516	7.4%	49.9%
Paga dhe kompensime	52,628	25,235	8.5%	47.9%
Mallra dhe shërbime	28,177	13,121	25.1%	46.6%
Transferta	271,970	136,164	7.0%	50.1%
Transferta sociale	209,100	103,069	10.1%	49.3%
FSPIMV	136,420	67,470	12.1%	49.5%
Kompensim financiar për të papunësuarit	3,576	907	21.7%	25.4%
Ndihma sociale	12,459	7,616	1.7%	61.1%
Mbrojtja shëndetësore	53,813	25,487	6.1%	47.4%
Transferta të tjera	62,871	33,095	-1.7%	52.6%
Interesa	21,277	11,996	-4.8%	56.4%
Shpenzime kapitale	40,122	19,371	53.5%	48.3%
SALDOJA E BUXHETIT	-39,239	-35,943	20.9%	91.6%

Burim: Ministria e Financave

Në periudhën janar – qershor të vitit 2026 në Buxhetin e RMV-së u realizua deficit prej 35,943 milionë denarëve, që paraqet 3.2% të PBB-së së projektuar për vitin 2026, përkatësisht 91.6% të planit vjetor (Tabela 2).

Në kuadër të Buxhetit të RMV-së, buxheti themelor realizoi deficit prej 38,850 milionë denarëve, fondet e suficitit prej 4,340 milionë denarëve, ndërsa llogaritë e të ardhura vetanake realizuan deficit në vlerë prej 1,433 milionë denarëve.


3.1.1. Realizimi i buxhetit themelor

Të ardhurat e përgjithshme të buxhetit themelor në periudhën janar - qershor të vitit 2026 ishin 102,877 milionë denarë. Ato paraqesin 45.4% të të ardhurave të përgjithshme të parapara për vitin 2026, në vlerë prej 226,667 denarëve.

Arkëtimi i të ardhurave tatimore në këtë periudhë, të cilat paraqesin zërin më të rëndësishëm në kuadër të të ardhurave të përgjithshme, ishin 94,712 milionë denarë, përkatësisht 45.2% të planit vjetor, ndërsa të ardhurat jotatimore dhe kapitale u realizuan në vlerë prej 8,165 milionë denarëve ose 47.6% krahasuar me vlerën e planifikuar për të gjithë vitin.

Struktura e të ardhurave tatimore të realizuara tregon se tatimi mbi vlerën e shtuar ka pjesëmarrjen më të madhe me 43,258 milionë denarë ose 45.7% e të ardhura tatimore të përgjithshme (Grafiku 9). Pastaj vijojnë të ardhurat mbi bazën e tatimit të të ardhurave personale me 17,539 milionë denarë, tatimi mbi fitimin me 13,809 milionë denarë, akcizat me 13,236 milionë denarë, detyrimet importuese me 7,652 milionë denarë dhe të ardhurat e tjera tatimore me -782 milionë denarë, për shkak të kthimit të tatimit solidar në vlerë prej 1,267 milionë denarësh.


Grafiku 9. Struktura e të ardhurave të realizuara tatimore, janar – qershor 2026



Realizimi i shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit themelor në periudhën janar – qershor të vitit 2026 shënon 141,727 milionë denarë ose 54.6% e mjeteve të përgjithshme të parapara me buxhetin themelor për vitin 2026.


Në strukturën e shpenzimeve të kryera në këtë periudhë, pjesëmarrjen më të madhe e zënë transfertat rrjedhëse në fondet buxhetore me 39,318 milionë denarë. Pastaj vijojnë pagat dhe kompensimet me 23,962 milionë denarë, subvencionet me 15,401 milionë denarë, transfertat rrjedhëse te njësitë e vetëqeverisjes lokale me 17,506 milionë denarë, pagesat për garancitë në vlerë prej 161 milionë denarë, shpenzimet kapitale me 16,020, pagesat e interesit me 11,996 milionë denarë, shpenzimet për mallrat dhe shërbimet me 9,741 milionë denarë, rezervat me 142 milionë denarë dhe benefitet sociale me 7,480 milionë denarë. Grafiku 10 tregon përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në shpenzimet e përgjithshme.

Grafiku 10. Struktura e shpenzimeve të realizuara sipas klasifikimit ekonomik, janar – qershor 2026



Shkalla e realizimit në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve është 54%. Grafiku 11 tregon të dhëna të ndara mbi shpenzimet e realizuara për mallrat dhe shërbimet.

Grafiku 11. Shpenzimet e mallrave dhe shërbimeve, janar- qershor 2026 (në miliona denarë)



Në gjysmën e parë të vitit, transfertat rrjedhëse te fondet buxhetore paraqesin 56.1% të planit vjetor. Në kuadër të kësaj kategorie, 88.6% janë transfertat në Fondin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë së Veriut (Fondi I SPIMV-së), ndërsa pjesa tjetër janë transfertat në Fondin e Sigurimit Shëndetësor.


Nga mjetet e përgjithshme të planifikuara për transfertat rrjedhëse drejt NJVL-ve për vitin 2026, në gjysmën e parë të vitit u realizuan 48.6%. Në kuadër të kësaj kategorie, vlera më e madhe ose 86.4% u realizua në bazë të dotacioneve bllok dhe atyre të dedikuara, ndërsa pjesa tjetër është në bazë të dotacioneve të TVSH-së.

Shkalla e realizimit në kategorinë e subvencioneve dhe transfertave në periudhën e shqyrtuar është 57.3%. Pjesa më e madhe e këtyre mjeteve, ose 5,659 milionë denarë, janë paguar në bazë të subvencioneve bujqësore nga Agjencia e Përkrahjes Financiare në Bujqësi dhe Zhvillim Rural.

Në periudhën janar – qershor, benefitet sociale paraqesin 62.3% të planit vjetor.

Në periudhën e shqyrtuar, shpenzimet kapitale paraqesin 62.9% të mjeteve të planifikuara për këtë qëllim në Buxhetin themelor për vitin 2026. Në grafikun 12 pasqyrohen të dhënat e ndara mbi shpenzimet kapitale të realizuara.

Grafiku 12. Shpenzimet kapitale janar – qershor 2026 (në miliona denarë)



Në periudhën e shqyrtuar, nga buxheti themelor është realizuar shlyerja e kryegjësë së borxhit të përgjithshëm në vlerë prej 60,659 milionë denarë, ndërsa pagesat e interesit janë 11,996 milionë denarë. Nga vlera e përgjithshme e fluksit dalës bazuar në shlyerjet e kredive, 11,644 milionë denarë ishin fluks dalës për shlyerjet e kryegjësë ndaj kreditorëve vendas, ndërsa 49,015 milionë denarë ishin fluks dalës për shlyerjet e kryegjësë ndaj kreditorëve jorezidentë. Për shpenzime interesi ndaj kreditorëve vendas u paguan 5,417 milionë denarë, kurse 6,579 milionë denarë ndaj kreditorëve të huaj.

3.1.2 Realizimi i buxhetit të fondeve

Në gjysmën e parë të vitit, Fondi i SPIMV-së realizoi suficit prej 3,456 milionë denarëve. Duke përfshirë muajin qershor, realizimi i të ardhurave dhe fluksit hyrës ishte 75,351 milionë denarë, që paraqet 49.9% e planit për vitin 2026, ndërsa realizimi i shpenzimeve ishte 71,895 milionë denarë, përkatësisht 47.6% e planit vjetor. Nga të ardhurat e përgjithshme 38,372 milionë denarë janë të ardhura bazuar në kontributet e sigurimit pensional dhe invalidor (46.1% e planit vjetor), 34,819 milionë denarë janë transfertat nga buxheti themelor, 815 milionë denarë janë të ardhura nga vetëpunësimi, 713 milionë denarë janë të ardhura nga akcizat, 401 milionë denarë janë të ardhura nga pagat, 105 milionë denarë janë të ardhura nga bujqit individualë, 100 milionë denarë janë të ardhura të tjera të Fondit, kurse 26 milionë denarë janë realizuar në bazë të të ardhurave nga dividendët.

Në pjesën e shpenzimeve të Fondit të SPIMV-së, shpenzimet për pensione u realizuan në vlerë prej 58,115 milionë denarë ose 49.7% e mjeteve të planifikuara për vitin 2026. Pagesa e pensioneve po realizohet në përputhje me dinamikën e planifikuar për vitin 2026. Transfertat nga Fondi i SPIMV-së në fondet private pensionale ishin 9,355 milionë denarë, kurse transfertat e kontributeve të sigurimit shëndetësor për pensionistët në Fondin e Sigurimeve Shëndetësore ishin 4,097 milionë denarë. Shpenzimet për paga, mallra dhe shërbime, kompensimet për lëndimet trupore dhe shpenzimet e tjera u realizuan në vlerë prej 328 milionë denarëve.

Duke përfshirë muajin qershor të vitit 2026, Fondi i Sigurimit Shëndetësor realizoi deficit prej 314 milionë denarëve, në kushte të të ardhurave të realizuara në vlerë prej 25,610 milionë denarëve, që paraqet

46.8% të planit vjetor dhe shpenzimeve të realizuara në vlerë prej 25,924 milionë denarëve, përkatësisht 47.4% të mjeteve të planifikuara për vitin 2026.

Në periudhën e shqyrtuar, të ardhurat nga kontributet e sigurimit shëndetësor ishin 16,626 milionë denarë ose 50.6% të planit vjetor. Kontributet e sigurimit shëndetësor për pensionistët të paguara nga Fondi i SPIMV-së ishin 4,097 milionë denarë, ndërsa kontributet e sigurimit shëndetësor të paguara nga Agjencia e Punësimit e RMV-së ishin 61 milionë denarë.

Transferta nga buxheti themelor ishin 4,472 milionë denarë, të ardhurat nga participimi ishin 317 milionë denarë, kurse të ardhurat e tjera ishin 37 milionë denarë. Në pjesën e shpenzimeve, janë realizuar shpenzime për mbrojtjen shëndetësore primare në vlerë prej 21,816 milionë denarë, shpenzimet për pushime mjekësore ishin 3,130 milionë denarë, për pajisjet ortopedike 343 milionë denarë, kurse për mjekim jashtë vendit 198 milionë denarë. Shpenzimet për paga, mallra dhe shërbime, si dhe shpenzimet kapitale ishin 437 milionë denarë.

Në periudhën janar – qershor 2026, Agjencia e Punësimit e RMV-së realizoi suficit prej 1,198 milionë denarëve, në kushte të të ardhurave të realizuara në vlerë prej 2,450 milionë denarëve (77% e planit për vitin 2026) dhe shpenzimeve të realizuara në vlerë prej 1,252 milionë denarëve (27.9% e buxhetit vjetor). Kontributet për sigurimin në rast të papunësisë janë zëri kryesor i të ardhurave dhe u realizuan në vlerë prej 2,433 milionë denarëve, përkatësisht 77.5% të planit vjetor.

Shpenzimet e Agjencisë së Punësimit në gjysmën e parë të vitit: në bazë të kompensimit në para për personat e papunë - 612 milionë denarë, në bazë të mjeteve për punësimin e personave me aftësi të kufizuara - 79 milionë denarë, për masat aktive të punësimit - 295 milionë denarë dhe për pagesën e kontributeve për pensionim dhe sigurim shëndetësor për personat e papunë - 61 milionë denarë. Shpenzimet e Agjencisë për paga, mallra dhe shërbime janë 205 milionë denarë.

3.1.3 Realizimi i buxhetit të llogarive vetanake për të ardhurat e shfrytëzuesve buxhetorë

Në përputhje me Buxhetin e RMV-së për vitin 2026, është planifikuar deficit buxhetor për buxhetet e llogarive të të ardhurave vetanake të shfrytëzuesve buxhetorë (të destinuara për aktivitete vetëfinancuese, hua dhe donacione) në vlerë prej 5,054 milionë denarëve, ndërsa deficitin i realizuar në periudhën e analizuar ishte 1,433 milionë denarë.

Duke përfshirë muajin qershor të vitit 2026, të ardhurat e përgjithshme të realizuara në këto llogari ishin 7,105 milionë denarë (30.3% e planit të vitit 2026), ndërsa shpenzimet e realizuara ishin 8,538 milionë denarë (30% e buxhetit vjetor). Në kuadër të shpenzimeve, për shpenzime rrjedhëse u shpenzuan 5,234 milionë denarë ose 37.5% e planit vjetor, ndërsa për shpenzime kapitale u shpenzuan 3,304 milionë denarë ose 22.7% e planit vjetor.

3.1.4 Realizimi i Buxhetit të RMV-së sipas shfrytëzuesve buxhetorë⁴

Më poshtë jepet pasqyrë e shpenzimeve dhe fluksit dalës nga buxheti i RMV-së për shfrytëzuesit më të mëdhenj buxhetorë, buxheti i përgjithshëm vjetor i të cilëve paraqet 91.6% të buxhetit të përgjithshëm të të gjithë shfrytëzuesve buxhetorë (Grafiku 13).

Në periudhën janar – qershor 2026, nëpërmjet Ministrisë së Financave – funksionet e shtetit⁵, u realizuan 76,858 milionë denarë, përkatësisht 69.6% e planit për vitin 2026. Shlyerja e kryegjësë (61,364 milionë denarë) është zëri më i rëndësishëm në shpenzimet e përgjithshme të këtij shfrytëzuesi buxhetor me pjesëmarrje prej 79.8%, ndërsa nga mjetet e planifikuara për vitin 2026, u realizuan 79.4%. Realizimi i interesit ishte 56.5% të


⁴ Të dhënat e detajuara mbi të ardhurat dhe shpenzimet sipas shfrytëzuesve buxhetorë janë paraqitur në tabelat në linkun e mëposhtëm: <https://finance.gov.mk/mk-MK/fushat/raporte-thesari>. Të dhënat janë preliminare dhe të pakonsoliduara dhe përfshijnë fluksin hyrës dhe fluksin dalës të mjeteve.

⁵ Në kuadër të kësaj ndarje përfshihen këto aktivitete: servieimi në kohë i detyrimeve të shtetit bazuar në huamarrjen e brendshme dhe të jashtme; pagesa e rregullt e kostove operative të shtetit bazuar në dokumentacionin e parashtruar paraprak për pagesë; pjesëmarrja në kapitalin e institucioneve financiare ndërkombëtare; pagesa e TVSH-së bazuar në investimet kapitale të financuara nga donacionet, financimi i projekteve nga komponentët e caktuara veçmas të IPA-s, etj.

vlërës për të gjithë vitin, ose 11,996 milionë denarë, me ç'rast ky zë merr pjesë në shpenzimet e përgjithshme me 15.6%. Zëri i tretë më i rëndësishëm, me pjesëmarrjes prej 3.1%, janë transfertat rrjedhëse te njësitë e vetëqeverisjes lokale, për të cilat u shpenzuan 2,384 milionë denarë.

Në gjysmën e parë të vitit 2026, Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë realizoi 46,026 milionë denarë ose 56.6% të buxhetit të planifikuar për vitin 2026. Me ç'rast, pjesa më e madhe (75.4%) e shpenzimeve në këtë periudhë ishin të destinuara për transfertat rrjedhëse te fondet, për të cilat u shpenzuan 34,686 milionë denarë ose 55.6% e mjeteve të destinuara për vitin 2026. Zëri i dytë më i rëndësishëm i shpenzimeve janë benefitet sociale, të cilat përbëjnë 16.2% në shpenzimet e përgjithshme dhe për këtë qëllim u realizuan 62.5% (7,478 milionë denarë) të planifikuara për vitin 2026.

Grafiku 13. Struktura e shpenzimeve dhe fluksit dalës të realizuara sipas shfrytëzuesve buxhetorë, janar - qershor 2026



Në periudhën janar – qershor 2026, Ministria e Arsimit dhe Shkencës realizoi mjete buxhetore në vlerë prej 22,914 milionë denarë (48.9% e vlerës së planifikuar), që është për 11.8% më shumë krahasuar me vitin paraprak. Pjesa më e madhe e shpenzimeve (54.6%) janë transfertat rrjedhëse te NJVL-të, për të cilat janë shpenzuar 12,524 milionë denarë ose 49% e mjeteve të përgjithshme të planifikuara. Pagat dhe kompensimet janë zëri i dytë më i rëndësishëm me pjesëmarrje prej 23.3% dhe për të janë shpenzuar 5,347 milionë denarë, përkatësisht 48.8% e mjeteve të përgjithshme të planifikuara.

Në gjysmën e parë të vitit 2026, Ministria e Punëve të Brendshme realizoi gjithsej 8,042 milionë denarë, që paraqet 48.5% të buxhetit të vitit 2026 dhe është 4.9% më shumë krahasuar me vitin paraprak. Zëri më i rëndësishëm i shpenzimeve janë pagat dhe kompensimet me pjesëmarrje prej 69.8%, për të cilat u shpenzuan 5,611 milionë denarë ose 49.8% e vlerës së planifikuar. Zëri i dytë më i rëndësishëm janë mallrat dhe shërbimet me pjesëmarrje prej 13.5% dhe për të cilat u realizuan 1,089 milionë denarë, që paraqet 37.4% të planit vjetor.

Në periudhën janar – qershor 2026, Agjencia e Përkrahjes Financiare në Bujqësi dhe Zhvillim Rural (APFBZHR) realizoi mjete në vlerë prej 5,969 milionë denarëve (78.7% e mjeteve të përgjithshme të planifikuara për vitin 2026). Zëri kryesor për këtë shfrytëzues buxhetor me pjesëmarrje prej 94.8% në shpenzimet e përgjithshme është subvencionet dhe transfertat, të cilat u realizuan në vlerë prej 5,659 milionë denarë, përkatësisht 82.6% e vlerës së planifikuar.

Në gjysmën e parë të vitit 2026, Ministria e Mbrojtjes realizoi mjete buxhetore në vlerë prej 8,961 milionë denarë, që është 40.4% e buxhetit të përgjithshëm për këtë vit. Krahasuar me vitin e kaluar, ato janë më

të ulëta për 13.5%. Shpenzimet për paga dhe kompensime kanë pjesëmarrjen më të madhe në shpenzime me 34.6%, për të cilat realizimi në periudhën janar – qershor 2026 ishte 3,099 milionë denarë (46.5% mjetëve të përgjithshme të planifikuara). Shpenzimet kapitale marrin pjesë me 30% në shpenzimet e përgjithshme. Për këtë qëllim u shpenzuan 2,691 milionë denarë, përkatësisht 29.6% nga mjetet e përgjithshme të planifikuara.

Në gjashtë muajt e parë të vitit 2026, Ministria e Ekonomisë dhe Punës realizoi mjete në vlerë prej 2,703 milionë denarëve, që është 49% e vlerës së planifikuar për vitin në fjalë. Zëri më i madh me pjesëmarrje prej 87.7% janë transfertat rrjedhëse te fondet, për të cilat u realizuan 2,370 milionë denarë ose 66.4% e mjetëve të planifikuara për vitin 2026.

Në gjysmën e parë të vitit, Ministria e Shëndetësisë realizoi mjete buxhetore në vlerë prej 4,098 milionë denarë (ritje prej 36% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar), që është 53.8% e buxhetit të përgjithshëm për vitin 2026. Transfertat rrjedhëse te fondet kanë pjesëmarrjen më të madhe në shpenzimet e përgjithshme me 48%, për të cilat u shpenzuan 1,966 milionë denarë në periudhën janar – qershor 2026, ose 56.2% e mjetëve të destinuara për vitin 2026. Shpenzimet për mallra dhe shërbime janë zëri i dytë më i rëndësishëm me pjesëmarrje prej 42.3% në shpenzimet e përgjithshme, kurse në periudhën e analizuar, për këtë qëllim janë shpenzuar 1,731 milionë denarë, përkatësisht 52.2% e mjetëve të përgjithshme të parashikuara.

Në periudhën janar – qershor 2026, Ministria e Transportit realizoi mjete në vlerë prej 10,893 milionë denarëve, që paraqet 81.4% të buxhetit të përgjithshëm për vitin 2026. Krahasuar me vitin e kaluar, ato janë më të larta për 124.2%. Zëri me pjesëmarrje më të lartë në shpenzimet e përgjithshme të këtij shfrytëzuesi buxhetor janë shpenzimet kapitale, realizimi i të cilave në gjysmën e parë të vitit 2026 ishte 10,220 milionë denarë (93.8% e shpenzimeve të përgjithshme), që është 83.7% e buxhetit vjetor për këtë qëllim. Për subvencione dhe transfertat u shpenzuan 448 milionë denarë, që është 65.8% e mjetëve të planifikuarave për të gjithë vitin, dhe me ç'rast në shpenzimet e përgjithshme marrin pjesë me 4.1%.

Në periudhën e dorëzimit të raportit, Propozimi për ndryshimin dhe plotësimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2026 ishte në procedurë parlamentare. Realizimi makroekonomik dhe fiskal në gjysmën e parë të vitit, u kushtëzua nga zhvillimet e jashtme, me ç'rast u imponua nevoja për ndryshime në Buxhetin e vitit 2026, përkatësisht rishikimi i projeksioneve fillestare, me qëllim të sigurimit të shpenzimeve të nevojshme të shfrytëzuesve buxhetorë për servisim të detyrimeve më prioritare, si dhe optimizimin e burimeve të financimit përmes shfrytëzimit të mjetëve nga aktivitetet vetëfinancuese. Si rezultat i zhvillimeve ekonomike, deficitin buxhetor u rishikua për 0.6% të projeksonit fillestar dhe është vendosur në nivel prej 4.1% të PBB-së, kryesisht për financimin e projekteve infrastrukturore.

Të ardhurat e përgjithshme janë planifikuar në nivel prej 379.5 miliardë denarë ose për rreth 1.2% më të larta, përkatësisht për rreth 4.6 miliardë denarë më shumë se projeksionet fillestare për vitin 2026. Shpenzimet e përgjithshme janë planifikuar në nivel prej 425.8 miliardë denarë ose më të larta për rreth 2.8% më shumë se projeksionet fillestare me Buxhetin e vitit 2026. Shpenzimet kapitale janë planifikuar në nivel prej rreth 46 miliardë denarëve me pjesëmarrje prej 4.1% të PBB-së së planifikuar, përkatësisht janë rritur për rreth 5.8 miliardë denarë ose për 14.5% krahasuar me Buxhetin e planifikuar fillimisht për vitin 2026.


3.2. Menaxhimi i borxhit publik

Borxhi shtetëror në fund të tremujorit të parë të vitit 2026 ishte 9,473.2 milionë euro, përkatësisht 51.9% e PBB-së së projektuar për vitin 2026, ndërsa borxhi publik⁶ ishte 10,747.4 milionë euro, përkatësisht 58.9% e PBB-së (Grafiku 14). Përveç kësaj, krahasuar me fundin e vitit 2025, pjesëmarrja e borxhit shtetëror në PBB është më e lartë për 0.3 p.p., kurse pjesëmarrja e borxhit publik është më e ulët për 0.5 p.p.. Të dhënat e nivelit

⁶ Me ndryshimet në Ligjin e Borxhit Publik në maj 2019 ("Gazeta Zyrtare" nr. 98/2019), borxhi i pasiguruar përfshihet në përkufizimin e borxhit publik.

të borxhit tregojnë stabilizimin e tij pas periudhës së rritjes së shkaktuar nga kriza Covid-19, me ç'rast niveli i borxhit mbetet i qëndrueshëm pavarësisht zhvillimeve të mëvonshme të pafavorshme gjeopolitike.


Grafiku 14. Gjendja e borxhit shtetëror dhe publik (në % të PBB-së)



Burimi: Ministria e Financave

Sa i përket strukturës së normave të interesit të borxhit shtetëror, në fund të tremujorit të parë të vitit 2026, raporti i normave fikse dhe variable të interesit ishte përkatësisht 78.7:21.3 (Grafiku 15). Sa i përket strukturës së monedhës, borxhi në monedhën vendase merr pjesë 36.6% në portofolin e borxhit të përgjithshëm shtetëror, ndërsa borxhi në monedhën e huaj ishte 63.4%. Përveç kësaj, pjesëmarrja e borxhit në euro në borxhin e përgjithshëm shtetëror është 59.8% (duke përfshirë letrat me vlerë shtetërore vendase me klauzolë devizore), të drejtat speciale të tërheqjes 3.4%, borxhi në jenin japonez 0.1% dhe borxhi në dollarë amerikanë 0.02%.

Grafiku 15. Struktura e normës së interesit (majtas) dhe struktura e monedhës (djathtas) e borxhit shtetëror në tremujorin e parë të vitit 2026



Në periudhën janar – qershor 2026, Ministria e Financave emetoi rregullisht letra me vlerë shtetërore në tregun vendas, në përputhje me kalendarin e emetimit të LSHV-ve.

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2026, u realizuan revizione të rregullta të vlerësimit kreditor të vendit nga agjencitë e vlerësimit kreditor "Fitch" dhe "Standard & Poor's".

• **Në muajin janar 2026**, Agjencia e Vlerësimit të Rejtingut Kreditor "Standard & Poor's" konfirmoi vlerësimin kreditor të vendit në "BB-" me perspektivë stabile. Konfirmimi i vlerësimit është sinjal i qartë i stabilitetit të politikës makroekonomike, nivelit të moderuar të borxhit publik dhe aftësisë së shtetit për të servisuar në kohë dhe për të siguruar në mënyrë të vazhdueshme detyrimet e tij financiare, si dhe vazhdimësinë në udhëheqjen e politikave ekonomike dhe në kushtet e rritjes së pasigurisë ekonomike globale. Në raport, Standard & Poor's potencon se rritja ekonomike po përshpejtohet, e mbështetur nga rritja e investimeve publike, veçanërisht në kuadër të projekteve të mëdha infrastrukturore, si dhe nga rritja e të ardhurave të amvisërive përmes rritjes së pagave dhe pensione. Agjencia pret që rritja ekonomike të arrijë rreth 3.5% në vitin 2026, ndërsa në periudhën afatmesme, rritja do të stabilizohet rreth 3%, me rritje graduale të rolit të investimeve private dhe kërkesës së jashtme.

Agjencia potencon gjithashtu përcaktimin e Qeverisë për të përshpejtuar rritjen ekonomike përmes realizimit të projekteve të mëdha infrastrukturore, si dhe përpjekjet e saj për përf forcimin e kapaciteteve institucionale, për përmirësimin e mjedisit afarist, arkëtimin më efikas të të ardhurave publike dhe uljen e ekonomisë gri. Në këtë raport theksohet se politikat synojnë mbështetjen e kërkesës së brendshme, përmes rritjes së pagave dhe pensione, si dhe konsolidimin e vazhdueshëm fiskal.

Me miratimin e Buxhetit për vitin 2026, siç theksohet në raport, parashikohet ulje e moderuar e deficitit buxhetor, i cili është projektuar në 3.5% të PBB-së, duke ruajtur nivelin e lartë të investimeve kapitale.

Të ardhurat pritet të rriten më shpejt se shpenzimet, si rezultat i përmirësimit të arkëtitimit të të ardhurave dhe aktivitetit të fuqishëm ekonomik, ndërsa ana e shpenzimeve mbetet e orientuar drejt investimeve kapitale në infrastrukturë, si dhe pagave, pensione dhe transfertave sociale.

Agjencia vlerëson se konsolidimi fiskal është në proces, megjithëse borxhi publik mbetet më i lartë krahasuar me periudhën para pandemisë. Standard & Poor's thekson në raport se risqet më rënie që lidhen me mjedisin e jashtëm, veçanërisht zhvillimet ekonomike në Bashkimin Evropian, balancohen kryesisht nga rezistenca e ekonomisë vendase, stabiliteti i sistemit financiar dhe qasja e kujdesshme e politikës monetare.

Agjencia gjithashtu në raport potencon se progresi i mëtejshëm në zbatimin e reformave institucionale dhe strukturore, veçanërisht në fushën e sundimit të ligjit dhe luftës kundër korrupsionit, mund të përforcojë më tej pozicionin ekonomik dhe fiskal të vendit dhe të kontribuojë në përmirësimin e profilit kreditor.

• **Në muajin prill të vitit 2026**, Agjencia e Vlerësimit të Rejtingut Kreditor "Fitch" konfirmoi vlerësimin kreditor të Republikës së Maqedonisë së Veriut në "BB+" me perspektivë stabile, duke dërguar sinjal të qartë sa i përket besimit në politikat ekonomike të vendit. Në raport, "Fitch" potencon se politikat makroekonomike të besueshme dhe të qëndrueshme, politikat afatgjate të kursit devizor fiks dhe treguesit e favorshëm të menaxhimit në krahasim me vendet me vlerësime të ngjashme mbeten faktorë kryesorë që mbështesin stabilitetin. Përveç kësaj, angazhimi ndaj procesit të anëtarësimit në BE vlerësohet si spirancë e rëndësishme reformash në periudhë afatmesme. Rritja reale ekonomike u përshpejtua në 3.5% në vitin 2025, e nxitur nga kërkesa e brendshme dhe investimet, të cilat u rritën për 8%. Pavarësisht sfidave nga mjedisi i jashtëm, "Fitch" pret që ekonomia të vazhdojë me rritje të qëndrueshme prej 3% në vitin 2026 dhe të përshpejtohet më tej në 3.4% në vitin 2027, gjë që e pozicionon vendin në destinacionin e qëndrueshëm sa i përket rritjes.

Politika fiskale mbetet e përcaktuar me kujdes dhe me përgjegjësi. Deficiti buxhetor mbahet në nivelin e planifikuar prej 4% të PBB-së në vitin 2025, me trajektore të qartë të uljes së tij graduale në 3.4% deri në vitin 2027. Në të njëjtën kohë, borxhi publik ruhet në nivel të moderuar dhe të kontrolluar, dukshëm nën kriteret evropiane, gjë që konfirmon më tej stabilitetin fiskal. Në raport gjithashtu potencohet ekspozimi ndaj risqeve të jashtme, veçanërisht në tregjet energjetike, por vlerëson se goditjet e tilla nuk do të kenë ndërprerje afatgjate në ekonomi. Inflacioni tregon trend stabilizimi, me pritshmëri për një nivel të moderuar në periudhën e ardhshme dhe stabilizim të mëtejshëm në vitin 2027. Konfirmimi i vlerësimit kreditor "BB+" me perspektivë stabile është sinjal i rëndësishëm për tregjet financiare ndërkombëtare dhe investitorët se Maqedonia ruan stabilitetin makroekonomik dhe ndjek politikë ekonomike të parashikueshme edhe në kushte të pasigurisë globale.